

Miftar KURTI & Ardita HAJDARI

KRIMET E FORCAVE SERBE NË KOMUNËN E MITROVICËS (1998-1999)

Forcat serbe që kanë kryer krime në Mitrovicë

Ushtria Jugosllave dhe forcat speciale të ushtrisë, njësitë antiterroriste të policisë serbe, forcat speciale të policisë sekrete, grupet paraushtarake, mercenarët ndërkombëtarë dhe serbët lokalë të armatosur kanë qenë të gjitha aktive në Kosovë gjatë luftës 1998-1999, në operacionet e koordinuara nga Beogradi. Kanë qenë aktive, kanë kryer krime dhe janë përgjegjës për krimet e luftës në Kosovë.¹ Në rajonin e Mitrovicës, gjatë periudhës kohore 1998-1999, krime kanë bërë: Brigada 125 e motorizuar,² një batalioni i Brigadës 252 të mekanizuar, Detashmentet 5 dhe 2 të Njësitë të Posaçme Policore (Posebna Jedinica Policia- PJP), Detashmenti 37 i Njësitë të Posaçme Policore (PJP-së); njësitë rezerviste të mobilizuara në kuadër të Sekretariatit të Punëve të Brendshme në Mitrovicës (SPB); forcat speciale policore nga Beogradi dhe qytetet e tjera të Serbisë³; Grupi Operacional i Ndjekjes (Operativni poterni grup)⁴; Brigada 37 e motorizuar, Brigada 211 e blinduar, Brigada 15 e blinduar, Brigada 58 e këmbësorisë së lehtë, Brigadat 2 dhe 1 të motorizuara, të cilat në operacione luftarake

¹ Human Rights Watch, *Nën pushtetin e urdhrave-Krimet e luftës në Kosovë*, New, York, Washington, London, Brussels, 2002, f. 65.

²Dosije: Dosije: 125. motorizovana brigada Vojske Jugoslavije, Fond za humanitarno prava; linku:

<http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2013/10/Dosije-125.pdf>,

qasja, 7.04.2020).

³ Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991, Lënda Nr. IT-05 87-T, Data: 26 shkurt 2009, Aktgjykimi 3 prej 4,

http://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/sq/090226_vol3.pdf , f. 429, 442, qasja 07.05.2020.

⁴ <https://pescanik.net/krivicna-prijava-fhp/>;

https://www.info-ks.net/vijesti/kosovo/114535/ko-jegoranradosavljevic-guri-koja-je-bila-njegova-uloga-nakosovu?fbclid=IëAR19LJCoS4457drAXkcajx1BVFKIjgCuz71DxibtN38_t37xE9FLHëvk-Q#4, qasja më 01.09.2020.

bashkëvepronin së bashku me forcat e MPB-së⁵; por edhe organet territoriale ushtarake që shtriheshin edhe në Mitrovicë.

Në Mitrovicë ishte vendosur edhe Detashmenti 54 i Degës Ushtarake të Qarkut të Prishtinës.⁶ Shumë aktive me mizoritë e tyre në këtë rajon ishin edhe Drejtoria e Sigurimit Publik dhe Drejtoria e Sigurimit Shtetëror të MPB-së. Drejtoria e Sigurimit Publik kishte edhe Sekretariatet e Punëve të Brendshme (SPB) në shtatë rajonet kryesore në Kosovë (njëri prej tyre në Mitrovicë) dhe stacionet policore, të cilat ushtruan dhunë e terror dhe bën krime të shumta.⁷

Prej janarit deri në ditët e para të prillit 1999, kanë kryer krime edhe Detashmentet 36 dhe 86 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilat nga qytete të ndryshme të Serbisë ishin dërguar në ndihmë Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Mitrovicës me qëllim të kryerjes së “detyrave të veçanta të sigurisë”. Në mars të vitit 1999, njësitet e policisë së rregullt dhe *Njësitë e Posaçme të Policisë (PJP) (Posebna Jedinica Policije)* në total numëronin 1 990 pjesëtarë, ndërsa njësitet e policisë rezervë 6 034 pjesëtarë. Në mars të viti 1999 në Mitrovicë vetëm forca policore kanë qenë të angazhuara rreth 8 000 pjesëtarë.⁸ Në operacione luftarake kanë marrë pjesë edhe Brigada 122 për Ndërhyrje të Njësisë së Posaçme të Policisë të MPB-së si dhe Forcat e JSO-së, të cilat ishin të stacionuara edhe në zonën e Mitrovicës.⁹ Pjesë e JSO-së ishin edhe “*Tigrat e Arkanit*”, të cilët kryenin krime edhe në këtë pjesë të Kosovës. Krime kanë kryer, gjithashtu, edhe

⁵ Međunarodni Krivični Sud za bivšu Jugoslaviju, Tužitelj protiv Milana Milutinovića, Nikole Šainovića, Dragoljuba Ojdanića, Nebojše Pavkovića, Vladimira Lazarevića i Sretena Lukića (I. dio), Predmet br. IT-05-87-T, Predmet 2 od 4, Datum: 26 februar 2009, https://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/bcs/jud090226p2_bcs.pdf, f. 284.

⁶ Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991, Lënda Nr. IT-05 87-T, Data: 26 shkurt 2009, Aktgjykimi Vëllimi 1 prej 4, http://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/sq/090226_voll1.pdf, f. 248-250, qasja 7.05.2020.

⁷ Human Rights Watch, *Nën pushtetin e urdhrave-Krimet e luftës në Kosovë*, New, York, Washington, London, Brussels, 2002, f. 86, qasja 2.05.2020.

⁸ Međunarodni Krivični Sud za bivšu Jugoslaviju, Tužitelj protiv Milana Milutinovića, Nikole Šainovića, Dragoljuba Ojdanića, Nebojše Pavkovića, Vladimira Lazarevića i Sretena Lukića (I. dio), Predmet br. IT-05-87-T, Predmet 2 od 4, Datum: 26 februar 2009, https://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/bcs/jud090226p2_bcs.pdf, p. 284.

⁹ Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991, Lënda Nr. IT-05 87-T, Data: 26 shkurt 2009, Aktgjykimi Vëllimi 1 prej 4, http://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/sq/090226_voll1.pdf, f.282.

serbët e romët lokalë të armatosur, si dhe mercenarë të ndryshëm, të cilët kanë vepruar në këtë rajon, si rusë,¹⁰ bjellorusë etj.¹¹

Bazuar në një urdhëresë të Sektorit të Ministrisë Federale të Jugosllavisë nr. 80/1, të datës 24.III.1999, ishte formuar i ashtuquajtimi Shtabi Kritik i Mitrovicës. Ky Shtab kishte në përbërjen e vet 24 anëtarë. Kryetar ishte emëruar Zdravko Trajković, kryeshef i Qarkut të Mitrovicës. Nën urdhrat e këtij Shtabi ose në koordinim me të vepronin edhe disa grupe kriminale serbe në Mitrovicë, siç ishin: “Grupi Bojçinët”, “Grupi i Thjeshtë”, “Djemtë e Frenkit” etj. “Grupi Bojçinët” kishte 23 anëtarë. “Grupi i Thjeshtë” përbëhej prej 14 vetash. “Djemtë e Frenkit” ishte një grup tjetër që vepronte në Mitrovicë. Në krye të këtij grupi ishte Vuçina Janiçević, kryepolic nga Vushtrria. Grupi vepronte në Mitrovicë, Vushtrri, Stanterg, Zubin Potok dhe Albanik. Ky grup kishte pesë togje.

Gjithashtu ekzistonte edhe një grup prej 65 vetash i “serbëve të Suhadollit”, të cilët vepronin dhe kryenin krime edhe në fshatrat shqiptare në Suhodoll, Vinarc i Poshtëm dhe Gushavc. Një grup tjetër i serbëve të armatosur vepronin edhe në fshatin Frashër i Madh të Mitrovicës. Në pozicionet luftarake të këtij grupi është gjetur regjistri origjinal shkruar në gjuhën serbe me shkrim cirilik. Sipas regjistrit grupi përbëhej prej tri togjeve. Në Lagjen “Kroi i Vitakut”, në Veri të Mitrovicës, vepronte edhe një grup tjetër i armatosur i serbëve. Grupi kishte në përbërjen e vet 33 anëtarë. Pjesë e grupit ishte edhe Sinisha Llaziq, kryetar i Partisë Radikale Serbe në Mitrovicë.¹² Siç thamë më herët, në rajonin e Mitrovicës ka vepruar edhe “Grupi Operacional i Ndjekjes” (Operativni poterni grup), i cili ishte pjesë e Departamentit të Zbulimit dhe Kundërzbulimit i Detashmentit 37 të PJP-së. Një pjesë e atyre që kanë marrë pjesë në krime dihen me emra dhe mbiemra. Këtë e pohojnë edhe burimet serbe. Disa prej atyre që dihet se kanë bërë krime janë: Radoslav Mitrovic (Guri), Sergjan Nikolic, Nenad Stojkovic, Zoran Markovic (me pseudonimin Çeçko), Dejan Mihajlovic (me pseudonimin Çeba), Dragan Milenkovic (me pseudonimin Shisharko etj.¹³ Gjurmët, emrat, mbiemrat kriminelët serbë i

¹⁰ Human Rights Watch, *Nën pushtetin e urdhrave-Krimet e luftës në Kosovë*, New, York, Washington, London, Brussels, 2002, f. 92, 93, 96; Safet Zeneli, *Terrorizimi serb mbi shqiptarët*, Kombi, 25 nëntor 1998.

¹¹ <https://cojstvo.rs/37->, qasja 26/06/2020; Safet Zeneli, *Terrorizimi serb mbi shqiptarët*, Kombi, 25 nëntor 1998.

¹² Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar*, VipRint, Mitrovicë, 2009, f. 290, 292-294, 299, 300-306.

¹³ <https://pescanik.net/krivicna-prijava-fhp/>;

<https://www.info-ks.net/vijesti/kosovo/114535/ko-je-goran-radosavljevic-guri-koja-je-bila-njegova-uloga-na>

kanë lënë edhe në fshatra të rajonit të Shalës. Nebojsja Pavloviq (Leshak, Laposaviq), Dragan Velkoviq, Sllavisha Tanaskoviq, Radomir Tanaskoviq, Stanimir Jovanoviq, Rato Milovanoviq, Nebojsja Bishevac, Muja Vaskoviq, Balovi (pseudonimi). Këta janë vetëm disa nga emrat e një pjese të atyre kriminelëve serbë që kanë vepruar dhe kryer krime në rajonin e Mitrovicës dhe Shalës së Bajgorës.¹⁴

Llojet e krimeve

Të gjitha këto njësi ushtarake, policore dhe speciale, kush më shumë e kush më pak, nën një Komandë të Përbashkët, me plane të detajuara, në qytetin e Mitrovicës dhe në zonat rurale (në Shalën e Bajgorës) kanë djegur e bërë rrafsh me tokë dhjetëra fshatra, lagje e paralagje të qytetit; kanë ekzekutuar, vrarë, masakruar, djegur, plagosur, burgosur e zhdukur shqiptarët në mënyrë mizore me lloj-lloj armësh. Kanë kryer krime me armë të ftohta: thika, sëpata etj; me armë zjarri të këmbësorisë pothuajse të të gjitha llojeve; me artileri (nga minahedhësit 60, 82, 120mm e deri te raketat); por edhe me aeroplanë luftarakë bombardues (MIG, GALEB). Se Serbia ka bombarduar popullatën civile edhe me aeroplanë, këtë e ka konfirmuar edhe gjenerali serb në pension Sreto Malinoviq, *komandanti i luftës i Regjimentit të 98-të të Aviacionit Bombardues*, i cili ka deklaruar publikisht se ishte njëri nga pjesëmarrësit në këto operacione.¹⁵ Si pasojë e këtyre operacioneve dhe bombardimeve me aeroplanë të UJ-së, më 2 prill 1999, ishte bombarduar shkolla fillore (e improvizuar si spital) në fshatin Bajgorë, ku ishin vrarë 2 dhe ishin plagosur 11 shqiptarë.

Në Mitrovicë janë kryer disa masakra, një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve janë dhunuar seksualisht. Me mijëra janë deportuar, me qindra janë zhdukur, vrarë, plagosur e burgosur. Numri i të ekzekutuarve, të vrarëve, të zhdukurve, të plagosurve dhe dhunimeve nga forcat serbe në Komunën e Mitrovicës 1998-1999 është i madh, lista është e gjatë. Lista emërore e tyre përfshinë të dy gjinitë, përfshinë moshën të ndryshme. Vrasjet e masakrat ndaj individëve dhe grupeve të qytetarëve ishin të tmerrshme. Me këtë rast do veçuar: vrasja dhe masakrimi me thikë i plakës 80-vjeçare Mihane Hyseni nga fshati Kaçanoll (15 shtator 1998); djegia në shtëpi e Rabije Zenelit nga fshati Mazhiq (15 shtator 1998); vrasja e plakut 80-vjeçar

[kosovu?fbclid=IëAR19LJCoS4457drAXkcaiqx1BVFKIjgCuz71DxibtN38_t37xE9FLHëvk-Q#4](https://www.kosovo.gov.mk/fbclid=IëAR19LJCoS4457drAXkcaiqx1BVFKIjgCuz71DxibtN38_t37xE9FLHëvk-Q#4), qasja më 01.09.2020.

¹⁴ Miftar Kurti, “Zbulohen emrat e kriminelëve që masakruan e dogjën popullatën shqiptare të Shalës së Bajgorës”, *Bota sot*, 11 prill 2000.

¹⁵ <http://www.rts.rs/page/stories/ci/story/124/drustvo/2259923/kako-je-vojska-jugoslavije-bombardovala-ovk-1999-godine.html>, qasja 29.03.2020.

Januz Shala nga fshati Vidishiq, të cilit ia nxjerrin syrin me thikë (15 shtator 1998). Fetah Behramit (60-vjeçar nga Kaçanolli), jo vetëm që ia nxjerrin sytë,¹⁶ por edhe ia prenë gjymtyrët: pëllëmbën e njëres dorë dhe bërrylin e dorës tjetër. Sipas deklaratës së bashkëshortes së djalit të tij, trupin e Fetahit e masakrojnë gjatë gjithë natës me duar të lidhura, derisa e gjymtojnë mizorisht.¹⁷

Në Mitrovicë, më 11 mars 1999, forcat policore e arrestojnë në shtëpinë e vet piktorin dhe poetin Kadri Kadriu, trupi i të cilit gjendet i masakruar më 12 mars, në Stanterg.¹⁸ Më 13 mars, në ora 14:20, në Tregun e Pemëve dhe Perimeve, forcat serbe hedhin 3 granata në mes të njerëzve, me ç'rast vriten 7 dhe plagosen 123 civilë. Trupa të pajetë, gjymtyrë të trupave shiheshin sheshazi pas asaj masakre.¹⁹ Më 24 mars, ditën e fillimit të bombardimeve të NATO-s kundër Serbisë e Jugosllavisë, forcat serbe, në Kroin e Vitakut, në Mitrovicë, shkojnë e marrin nga shtëpia dhe e pushkatojnë para shtëpisë, profesorin universitar 67-vjeçar Latif Berisha.²⁰ Po atë ditë, në shtëpinë e tij në Mitrovicë, e pushkatojnë edhe Agim Hajrizin, kryetar i Sindikatës së Pavarur të Kosovës, së bashku me nënën e tij, Nazmijen (60 vjeçare), dhe djalin, Ilirin (12-vjeçar).²¹

Më 28 mars, në fshatin Suhodoll i Epërm, vriten 7 shqiptarë (5 nga fshati në fjalë dhe 2 ishin mysafirë: 1 nip dhe 1 dhëndër). Më 20 maj 1999, forcat serbe e vrasin Lulzim (Qazim) Baliun, pastaj e masakrojnë, duke ia nxjerrë edhe zemrën. Forcat serbe, në Komunë e Mitrovicës, kanë bërë edhe ekzekutime në grupe të shqiptarëve. Më 29 mars, në Lagjen “Bair” të Mitrovicës, forcat serbe pushkatojnë edhe 4 pleq, dy gra dhe dy burra, të cilët ishin të palëvizshëm. Më 14 prill të atij viti, forcat serbe, në Lagjen “Qendra 1”, në “Rrugën e Kovaçëve”, në qytetin e Mitrovicës, i nxjerrin dhunshëm nga shtëpitë e tyre, i grumbullojnë në një vend 100 shqiptarë, pastaj i pushkatojnë 31 prej tyre.²² Këto janë vetëm disa nga krimet

¹⁶ Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar...*, f. 201.

¹⁷ Safet Zeneli, *Terrori serb mbi shqiptarët*, Rrëfim, Kombi, 25 nëntor 1998, f. 29.

¹⁸ *Kosova sot*, 13.03.1999.

¹⁹ “Koha ditore”, 14.03.1999; Vehbi Beqiri, *Ditari i luftës* (Dorëshkrim); Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar...*, f. 225, 226; Fjalori Enciklopedik i Kosovës, ASHAK, Prishtinë, 2018, f. 1063-1064.

²⁰ Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar...*, f. 233.

²¹ Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991, Lënda Nr. IT-05 87-T, Data: 26 shkurt 2009, Aktgjykimi 3 prej 4, http://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/sq/090226_vol3.pdf, f. 257, qasja 7.05.2020.

²² Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar...*, f. 233, 380.

monstruoze të ushtrisë jugosllave, policisë speciale dhe sekrete serbe, por edhe forcave të tjera ushtarake, paraushtarake e policore jugosllave.

Të ekzekutuarit, të vrarët dhe të zhdukurit e Komunës së Mitrovicës

Për krimet e kryera të forcave serbe ndaj shqiptarëve flasin dëshmitë dhe të dhënat e organizatave të ndryshme, si: *Human Right Watch*, *Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut* (KLMDNJ), *Fondit për të Drejtën Humanitare* (FDH) etj. Sipas *Fondit për të Drejtën Humanitare*, nga 926 dokumente sa kjo organizatë ka mbledhur nga burimet të ndryshme, del se vetëm në Komunën e Mitrovicës, janë vrarë dhe zhdukur 529 shqiptarë.²³

Mosha dhe profesioni i të vrarëve në Komunën e Mitrovicës, sipas KMDLNJ-Qendra Rajonale në Mitrovicë, ishte: deri në 7 vjeç (6), 8-14 vjeç (9), 15-18 (18), 19-60 vjeç (347), 60 vjeç (74). Femra të vrara (66), kurse meshkuj (388). Të vrarët sipas profesionit ishin: nxënës (26), teknologë (5), muratorë (9), amvise (40), bujq (24), pensionistë (50), studentë (38), arsimtarë (5), punëtorë krahu (11), piktorë (2), ish-policë (2), ish-minatorë (14), axhustatorë (4), nëpunës (1), fëmijë (6), vozitës autobusi (3), këngëtar (1), tregtar (1), roje pylli (1), inxhinierë (4), teknik ndërtimi (1), ekonomistë (7), jurist (1), berber (1), rojtar (1), teknik makinerie (1), kamarierë (2) dhe bari (1). Në Mitrovicë janë evidentuar 229 të zhdukur, 129 prej tyre ende janë të pagjetur. Mosha dhe profesioni i tyre ishte: 15-18 (6), 19-60 (105), mbi 60 vjeç (18). Sipas gjinisë: 19 femra dhe 110 meshkuj. Profesionet e të zhdukurve ishin: të papunë (44), amvise (17), mjekë (2), profesor (1), bujq (7), gjimnazistë (12), studentë (10), nxënës (7), pensionistë (9), ekonomistë (2), hendbollistë (2), inxhinierë (2), punëtorë krahu (4), minator (1), tregtarë (2), axhustatorë (2), polic (1), vozitës autobusi (1), murator (1), teknolog (1) dhe automekanik (1).²⁴

Sipas *Fondit për të Drejtën Humanitare* (FDH), shikuar sipas gjinisë, të vrarë dhe të zhdukur janë 459 meshkuj shqiptarë dhe 70 femra. Mosha e tyre është si vijon: 0-7 vjet (4), 8-18 (29), 19-25 (83), 26-35 (103), 36-55 (161), 56-70 (77), mbi 70 (59), e panjohur 13. Shikuar sipas muajve, sipas të njëjtit burim, në vitin 1998, të dhënat duken kështu: në janar, shkurt dhe nëntor nuk kishte asnjë të vrarë, në mars kishte 1, në maj 2, në qershor 2, në korrik 4, në gusht 2, në shtator 25, në tetor 2 dhe në dhjetor 3. Në vitin 1999: në janar janë vrarë 6, në shkurt 3, në mars 67, në prill 199, në maj 147

²³ Fondi për të Drejtën Humanitare, *Libër kujtimi i Kosovës*, <http://www.hlc-rdc.org/?cat=218&lang=zh>, qasja 01.05.2020.

²⁴ Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar...*, f. 250, 251, 255.

dhe në qershor 66. Gjithsejtë në Komunën e Mitrovicës, nga 1 janari 1998 deri më 14 qershor 1999, sipas FDH-së, janë ekzekutuar dhe vrarë 452 (civilë dhe ushtarë të UÇK-së), kurse janë zhdukur 77 civilë dhe ushtarë.²⁵ Sipas KLMDNJ-Qendra Rajonale në Mitrovicë, lista emërore e të vrarëve është e gjatë.²⁶

²⁵ Fondi për të Drejtën Humanitare, *Libër kujtimi i Kosovës*, <http://www.hlc-rdc.org/?cat=218&lang=zh>, qasja 01.05.2020.

²⁶ Abaz (Ibish) Mecinaj, Abedin (Imer) Haxha, Abedin (Nuredin) Selmani, Abide (Asllan) Shala, Abit (Bajram) Ujkani, Adem (Muharrem) Demiri, Adem (Rifat) Peci, Adem (Tefik) Azemi, Afrim (Xheladin) Hyseni, Afrim (Idriz) Peci, Afrim (Shaban) Shabani, Agim (Mehmet) Hajrizi, Ahmedin (Sylë) Uka, Ahmet (Avdi) Strana, Ahmet (Mehmet) Bajrami, Ahmet (Qerim) Rexhepi, Ajet (Bajram) Xhemajli, Ajet (Jetullah) Latifi, Ajet (Xhemë) Zejnullahu, Albert (Taip) Halili, Adem (Hetem) Haziri, Arben (Emin) Emmini, Ardita (Hilmi) Haliti, Arif (Ramë) Igrishta, Arife (Halim) Hasani, Ajete (Avdyl) Ferati, Arsim (Brahim) Beqiri, Arsim (Isa) Sherifi, Asllan (Tahir) Deliu, Avdi (Miran) Ferizi Avdi (Hysen) Vrellaku, Avdullah (Zymer) Haxhimehmeti, Avdyl (Xhevat) Ismajli, Avni (Kadrush) Abazi, Avni (Alush) Alushi, Avni (Hashim) Sylja, Azem (Bali) Nehmeti, Azem (Qerim) Zeneli, Bahri (Imer) Ferati, Bahri (Jahir) Hajdari, Bahri (Rrahim) Selimi, Bahri (Smail) Veseli, Bahrije (Arif) Hajdari, Bajram (Avdi) Tahiri, Bajram (Rrahim) Islami, Bajram (Rexhep) Kurti, Bajram (Salih) Hasani, Bashkim (Jahir) Kurti, Bashkim (Tahir) Peci, Bashkim (Xhemajl) Abazi, Bedri (Bajram) Selmani, Bedri (Nezir) Muja, Bedri (Qazim) Baliu, Bedrije (Elez) Terrstena, Behxhet (Metë) Vidishiçi, Bejtush (Sahit) Haziri Bekim (Murtez) Karakashi, Bekim (Habib) Selmani, Beqir (Milazim) Hajra, Beqir (Ahmet) Hajdari, Besim (Elez) Terrstena, Besim (Januz) Miftari, Besnik (Ajet) Gjeloshi, Bislim (Ramë) Trepça, Bislim (Tafil) Bislimi, Blerim (Beqir) Avdyli, Blerim (Idriz) Ferizi, Ibrahim (Ukë) Meziu, Ibrahim (Rexhep) Shala, Bujar (Faik) Pllana, Bujar (Hetem) Halili, Bislim (Bajram) Ademi, Cenë (Hamdi) Hasani, Deli (Bajram) Jusufi, Dervish (Tafil) Kahrmani, Driton (Abit) Smakolli, Driton (Bajram) Xhafa, Elez (Elez) Begu Elfete (Jetullah) Aliu, Elfije (Haxhë) Uka, Elvane (Sheremet) Haxha, Emine (Emin) Muharremi, Emir (Shefqet) Pllana, Enes (Shefqet) Pllana, Enver (Halim) Ferizi, Enver (Mehmet) Munoglli, Enver (Daut) Peci, Enver (Rexhep) Hajdari, Enver (Tafil) Kahrmani Eroll (Muharrem) Mustafa, Heset (Zahit) Zahiti, Eshref (Fazli) Emmini, Fadil (Musli) Ismajli, Fadil (Latif) Sahiti, Fadil (Shahin) Ademi, Fadil (Vesel) Kurti, Fahredin (Aqif) Uka, Fahredin (Ramë) Sokoli, Fahri (Ahmet) Kelmendi, Fahri (Jetullah) Aliu, Faik (Hysen) Vidishiçi, Faik (Mursel) Islami, Fatime (Muharrem) Gjaka, Fatmir (Muharrem) Mustafa, Fatmir (Nezir) Avdyli, Fatmir (Tafil) Shosholli, Fatmir (Xhemajl) Miftari, Fatos (Ismet) Binaku, Fatos (Mustafë) Gjaka, Fazli (Ali) Haxhiu, Fazli (Ferat) Zenuni, Fazli (Hamëz) Hasani, Fehmi (Kamir) Miftari, Fehmi (Rexhep) Alushi, Feriale (Murtez) Spasolli, Feriz (Selim) Zeneli, Fetah (Avdyl) Tahiri, Fetah (Sefer) Behrami, Fevziye (Rexhep) Fejzullahu, Fidan (Bajram) Peci, Flamur (Abedin) Hoxha, Flurim (Isa) Peci Fatime (Hasan) Zeqiri, Gani Kelmendi, Gani (Man) Neziri, Gani (Veli) Haxha, Gani (Xhevat) Peci, Gëzim (Mursel) Veliu, Gëzim (Samedin) Vatovci, Gyltene Hoxhaxhiku Ilaz (Bali) Hyseni, Hajdar (Ahmet) Hajdari, Hajdin (Rushit) Ukshini, Hajdin (Osman) Hajdini, Hajriz (Ahmet) Miftari, Hajrullah (Halil) Xhaka, Hajzer (Ahmet) Miftari, Hajzer (Ferat) Ademi, Hajzer (Hamit) Manaj, Hajzer (Zenel) Rrahmani, Haki (Ali) Misini, Haki (Aziz) Kurshumliu, Halil (Qazim) Brahimi, Halil (Kadri) Haliti, Halili (Hasan) Hasani, Halil (Osman) Ademi, Halil (Rexhep) Mustafa, Halil (Selim) Zeka, Halil (Shashivar) Miftari, Halim (Halil) Ferizi, Halit (Ali) Shala, Halit

(Ilaz) Sylejmani, Halit (Qazim) Brahimi, Halit (Selman) Tahiri, Hamdi (Demir) Hasani, Hamdi (Zeqir) Hasani, Hamide (Ahmet) Rreci, Hamide (Shaban) Musa, Hamit (Sylë) Miftari, Hanë (Hamit) Sahiti, Hanife (Xhemajl) Miftari, Hanife (Rexhep) Ajeti, Hajredin (Shaban) Hasani, Hashim Parduzi, Haxhi (Faik) Çitaku, Hazir (Sabri) Feka, Hazir (Sylë) Miftari, Hetem (Brahim) Hamza, Hetem (Riza) Haliti, Hidajete (Hajzer) Hyseni, Hidë (Ajet) Kamberi, Hilmi (Alush) Alushi, Hilmi (Halil) Ferizi, Hilmi (Sadri) Kelmendi, Hysen (Islam) Skuroshi, Hysni (Abaz) Ferizi, Hysnie (Ibrahim) Morina, Hajdin (Istref) Bislimi, Ibadete (Sheremet) Haxha, Ibrahim (Nuredin) Fejzullahu, Ibrahim (Izet) Sylejmani, Ibrahim (Hamzë) Sylejmani, Igballe (Mehmet) Smajli, Ilaz (Adem) Tahiri, Ilaz (Xhemajl) Maksuti, Ilirjan (Agim) Hajrizi, Ilmi (Jashar) Kajtazi, Imer (Hasan) Jashari, Florid (Nebih) Salihu, Irfan (Ilaz) Zhilivoda, Isa (Islam) Shaqiri, Eset (Behram) Hajrizi, Islam Shabani, Islam (Tahir) Miftari, Ismajl (Beqir) Loshi, Ismet (Ahmet) Begu, Ismet (Fetah) Rexhepi, Ismet (Halit) Haliti, Ismet (Mustafë) Sejdiu, Istref (Shahin) Avdiu, Istref (Xhevat) Ferati, Isuf (Jonuz) Rushiti, Isuf Supnaj, Izer (Lah) Fejzullahu, Jahja (Mehmet) Beka, Jonuz (Nazif) Jashari, Jashar (Shefik) Begu, Jeton Jakupi, Jeton (Osman) Peci, Jeton (Shefqet) Ahmeti, Jonuz (Deli) Shala, Kadri (Hajriz) Kadriu, Kadri (Munish) Istogu, Kadri (Ramë) Haziri, Kadri (Salih) Uka, Kamber (Alush) Bacaj, Jashar (Fetah) Bajrami, Kadrije (Haqif) Uka, Kadrush (Bislim) Musa, Latif (Mehmet) Berisha, Lavdim Shita, Luan (Halit) Balaj, Lulzim (Bajram) Peci, Lulzim (Ibish) Isufi, Lulzim (Qazim) Baliu, Leunora (Shemsi) Ferizi, Lumnije (Fehmi) Miftari, Lutfi (Emin) Hasani, Magbule (Ali) Muja, Mahmud (Rrustem) Rushiti, Mehmet (Izet) Tupella, Mexhit (Bejtë) Rushiti, Mexhit (Ibrahim) Kurti, Mehdi (Mursel) Tahiri, Mehmet Seferi, Rifat (Alush) Zeneli, Melihate (Sefer) Miftari, Mensur (Nazif) Salihu, Mentor (Ukshin) Murati, Mevlude (Hashim) Uka, Miftar Krasniqi, Mihrije (Osman) Rreci, Milazim (Hetem) Ferati, Minir (Ragip) Azemi, Muzafere (Ilmi) Miftari, Muhamet (Mahmut) Gjyshinca, Muhamet Maxhuni, Muharrem Haziri, Muharrem (Mehmet) Rexhepi, Muhamet (Hajdin) Hasani, Muhedin (Kadri) Jonuzi, Mujë (Abaz) Parduzi, Murat (Bajram) Emimi, Murat (Ilaz) Islami, Murat (Shaban) Peci, Murat Zeqiri, Mursel (Rexhep) Hajra, Mustafë (Mustafë) Sejdiu, Mustafë (Bahtir) Shala, Mustafë (Shaqir) Shyti, Mustafë (Zair) Supnaj, Mustafë (Brahim) Zatriqi, Mihane (Bahtir) Hyseni, Naim (Bajram) Tahiri, Naim (Nezir) Segaqi, Naim (Raif) Zhegrova, Naser (Qazim) Haziri, Nazif (Idriz) Xhafa, Ismail (Rizah) Mehana, Nazmije (Nebih) Mëziu, Nazmi (Hasan) Beka, Nazmi (Smajl) Mazhiqi, Nazmije (Hasan) Haziri, Nevzat (Latif) Ademi, Nexhat (Shefqet) Azemi, Nexhat (Skender) Taraku, Nexhat (Vesel) Ujkani, Nexhip (Hajzer) Osmani, Nexhmedin (Hetem) Mëziu, Nexhmedin (Rizah) Musliu, Nexhmedin (Zejdi) Hajzeri, Muharrem (Hetem) Haziri, Nexhmedin (Sahit) Sadiku, Nexhmedin (Ahmet) Syla, Nexhmi (Halil) Musa, Rrahman (Idriz) Ferati, Nezir (Abaz) Tahiri, Nezir (Sit) Sinani, Niman Sejdiu, Njazi (Sherif) Zymberi, Nuhi (Mehmet) Rrahmani, Nysret (Abdyrrahman) Ferati, Nysret (Ahmet) Peci, Pakize (Hasan) Deliu, Qamil (Avdyl) Behrami, Qamil (Sabri) Pllana, Qamil (Musli) Smajli, Qazim (Xhemajl) Baliu, Qerim (Ibrahim) Rexhepi, Qerim (Selim) Dauti, Rabije (Shyqyri) Jusufi, Ragip (Rifat) Bajrami, Ramadan (Enver) Hyseni, Ramadan (Bajram) Istrefi, Ramadan (Cenë) Haziri, Ramadan (Kadri) Ujkani, Ramë (Bali) Uka, Ramiz (Beqir) Beqiri, Remzi (Aziz) Aliu, Remzije (Bajram) Canhasi, Rexhep (Smajl) Behrami, Rexhep (Fehmi) Alushi, Rexhep (Mustafë) Sejdiu, Rifadije (Ferat) Ferati, Rifat (Faik) Smakolli, Rifat (Hetem) Ferati, Rifat (Brahim) Imeri, Rifat (Sejdi) Smakolli, Rizah (Ferat) Tahiri, Rrahim (Azem) Voca, Rrahim (Beqir) Beqiri, Rrahim (Fazli) Hajdari, Rrahim (Miftar) Mustafa, Rrahim (Avdi) Peci, Rrahim (Sejdi) Hajzeri, Rrahim (Bahri) Vehapi, Rrahman (Ajet) Hyseni, Rrustem (Halil) Hasani, Ruzhdi (Kadri) Isufi, Sabrije (Shaban) Igrishita, Sedat Peci, Sadije Fejzullahu, Sadik (Murat) Hyseni, Sadik (Kamer)

Mitrovica, gjithashtu, pësoi edhe nga një element tjetër i gjenocidit. Forcat serbe zhdukën pa gjurmë qindra shqiptarëve nga rajoni i Mitrovicës. Të pagjetur rezultojnë 129: 110 meshkuj dhe 19 femra. Në mesin e tyre edhe: 7 nxënës, 10 studentë, 1 profesor dhe 2 mjekë.²⁷

Uka, Sadri (Zenel) Shala, Salë (Haradin) Imeri, Salih (Bajram) Hasani, Salih (Hamit) Peci, Sami (Faik) Sahiti, Gjemile (Hysen) Musliu, Sami (Nazif) Kelmendi, Sanije (Abdullah) Mëziu, Sanije (Idriz) Miftari, Sebahate (Xhemë) Maksuti, Sebahate (Ramadan) Çollaku, Musa (Selman) Bagolli, Sefedin (Niman) Shala, Sefedin (Sejdi) Hajzeri, Sefer (Ferat) Ademi, Sefer (Zenel) Osmani, Sejdi (Hashim) Rushiti, Selim (Jashar) Segaçi, Selim (Hajr) Musa, Selim (Avdyl) Latifi, Selim (Rexhep) Zeneli, Selman (Kadri) Mustafa, Selman (Nazif) Peci, Selman (Feriz) Sejdiu, Selvet (Tahir) Hajdini, Servet (Ilaz) Berisha, Sevdije (Hajdar) Selani, Shaban (Hysen) Gashi, Shaban (Kadri) Istogu, Shaban (Kadri) Sadiku, Shaban (Salih) Igrishita, Shaban (Sherif) Shala, Shahin (Muharrem) Ademi, Shaqir (Rizah) Selimi, Shemë (Fehmi) Begu, Shemsi (Fejzullah) Balinca, Shemsi (Ramadan) Hajdari, Sherif (Isa) Sherifi, Sherife (Beqir) Avdyli, Shkëlqim (Shahin) Ademi, Shqipe (Hashim) Mustafa, Bajram (Sherif) Hyseni, Shukrije (Shaban) Sylja, Sinan (Daut) Sadiku, Sinan (Kadri) Barani, Skënder (Ali) Osmani, Skender (Jonuz) Rexha, Skender (Hamit) Paçarada, Ukshin (Avdullah) Ferati, Smajl (Bahtir) Smajli, Smakë (Hamëz) Maliqi, Sokol (Daut) Fazliu, Sylë (Lah) Beka, Sylë (Smakë) Sylja, Sylejman (Hajdar) Tahiri, Sylejman (Miftar) Kalludra, Tafil (Ibish) Deliu, Taip (Halil) Halili, Ukshin (Ukë) Murati, Vahide (Bajram) Fejzullahu, Vahide (Ilaz) Tahiri, Vahide (Mursel) Zeka, Valdet (Isa) Strana, Vehbi (Adem) Musliu, Vesel (Sinan) Ahmeti, Vesel (Ilaz) Istrefi, Veton (Mustafë) Peci, Xhafer (Azem) Hajdari, Xhafer (Bejtë) Preteni, Xhafer (Hazir) Kamberaj, Xhafer (Miftar) Sylja, Xhavit (Hajredin) Bislimi, Xhavit (Rasim) Zeneli, Xhelal (Ismet) Jakupi, Xhemajl (Abit) Hyseni, Xhemajl Isufi, Xhemajl (Abaz) Maksuti, Xhemë (Ali) Xhema, Xhemë (Rrustem) Azemi, Xhemë (Rushit) Azemi, Xhemil (Gani) Hoti, Xhenis (Fehmi) Miftari, Xhevat (Beshir) Ademi, Xhevat (Rrustem) Hajdari, Xhevdet (Ali) Hasani, Xhevdet Kelmendi, Xhyla (Shaban) Peci, Xhylazim (Nuredin) Zeneli, Zarife (Ismajl) Marteta, Zarife (Sadik) Tmava, Zeki (Jusuf) Llapashtica, Zeqir (Behë) Muja, Zeqir (Januz) Jonuzi, Zeqir (Muhamet) Haradinaj, Zylfije (Jashar) Kalludra, Zymer (Sefer) Feka, Xhevrije (Fetah) Sylja, Zeqir (Rrahman) Zeqiri, Emine (Emin) Muharremi, Isa (Metë) Begolli, Nexhmedin (Sahit) Sadiku, Imer (Rrustem) Rexhepi, Gojko Jeftiq, Dragi Kovaqeviq, Dejan Kostiq, Sejdi (Hashim) Rushiti, Elizabeta (Isa) Hasani, Ramishe (Alush) Zeneli, Xhevdet (Mexhit) Ahmeti, Ahmet (Hajriz) Miftari, Lulzim (Xhemajl) Miftari, Sami (Hazir) Feka, Sadete (Hazir) Feka, Behram (Sylë) Rrahmani, Mursel (Dan) Ibrahim, Sabedin (Sherif) Januzi, Tahir (Zymer) Tahiri²⁶.

²⁷ Abdullah (Mehmet) Istrefi, Adem (Fazli) Ademi, Adem (Muhamet) Beqiri, Afrim (Brahim) Meholl, Ahmet (Hajriz) Miftari, Ahmet (Mehmet) Musa, Ali (Islam) Spahiu Arif (Ramë) Igrishita, Armend (Halil) Hasani, Azem (Behram) Tahiri, Azem (Deli) Deliu, Ajete (Avdyl) Ferati, Arsim (Sejdi) Bekteshi, Ali (Halil) Qeliku, Azem (Syle) Smajli, Bahri (Jahir) Hajdari, Bajram (Jonuz) Muçiçi, Bardhec (Mehmet) Ibishi, Batri (Izet) Tupella, Bekim (Hetem) Bajgora, Bekim (Hamzë) Rrecaj, Beqir (Ahmet) Hajdari, Blerim (Mehmet) Mehmeti, Beqir (Latif) Bilalli, Bedri (Ahmet) Kelmendi, Besim (Sinan) Baliu, Blerim (Ramadan) Neziri, Bahri (Halil) Uka, Deli (Bajram) Isufi, Driton (Xhafë) Azemi, Dibran (Ramë) Dibrani, Esat (Sherif) Ibrahim, Fadil (Nezir) Avdyli, Ferki (Sejdi) Ujkani, Fadil (Halil) Hasani, Fadil (Nebih) Fazliu, Fadil (Ramiz) Mustafa, Faton (Sadri) Ujkani, Fazlije (Fetah) Sahiti, Ferit (Vesel) Preteni, Fuat (Xhemajl) Berani, Fatmir (Bahri) Berisha, Fatime

Dhuna seksuale

Një nga krimet më monsturoze të forcave serbe është edhe dhuna seksuale. Gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, kanë ndodhur dhunimet më çnjerëzore, më barbare, duke mos kursyer as fëmijët që nga mosha 7-vjeçare e deri moshës 65-vjeçare. Burime të ndryshme flasin se në Kosovë kemi mbi 20 mijë viktima të dhunës seksuale. Një numër i madh i tyre nuk arriti që t'ju mbijetoi plagëve të këtij krimi monstroz. Të dhunuar ishin meshkuj dhe femra, të sëmurë mendorë dhe fizikë. Nga të dhënat e grumbulluara deri më 2019, dihet se në 80 lokacione kanë ndodhur dhunime në grupe. Dhunimet janë bërë në vende të ndryshme duke mos përjashtuar këtu objekte kulturore, fetare, shkolla, spitale etj. Nga të dhënat që ne kemi arritur të sigurojmë del se deri më tani në Mitrovicë janë raportuar një numër i vogël. Në Mitrovicë, deri para një viti janë raportuar vetëm 64 raste të dhunimeve. Shifrat për komunën e Mitrovicës (sigurisht në disa komuna të tjera) janë të lëvizshme. Ato ndryshojnë nga dita në ditë, ngase nuk ka asnjë bazë apo qendër ku të dhënat janë të centralizuara. Kësisoj, jo pak raste ka kur një e mbijetuar është paraqitur në njërin nga Organizatat në

(Alush) Jaha, Gazmend (Halil) Hasani, Gëzim (Ibrahim) Sejdiu, Gëzim (Nebih) Ferizi, Halit (Rizah) Sylejmani, Hysen (Nebih) Sylja, Halim (Zejnullah) Kelmendi, Halil (Kadri) Dobra, Hamit (Nezir) Miftari, Hamzë (Rasim) Hajrizi, Hanife (Rexhep) Ajeti, Hasan (Bajrush) Dërvari, Hasan (Halil) Hasani, Halit (Jahir) Istrefi, Haxhi (Halit) Latifi, Ibrahim (Bajram) Zeqiri, Ilmi (Fazli) Aliu, Ilmi (Emin) Cimili, Islam (Qerim) Hasani, Islam (Sherif) Selmani, Irena (Adem) Deliu, Jashar (Bajram) Qerkini, Kemajl (Fetah) Koca, Liman (Tahir) Avdiu, Mevlude Sylejmani, Mahit (Halil) Ujkani, Mevlude Uka, Mehmet (Hysen) Hyseni, Muhamet (Ahmet) Qoroviq, Mevlude (Sylejman) Dubreva, Milazim (Selim) Zeqiri, Nazmi (Rasim) Bajgora, Nazmi (Zahit) Ujkani, Nesad (Ismajl) Haxha, Nezir (Hasan) Sadiku, Nezir (Xhevat) Shabani, Nysret (Hasan) Hoti, Nysret (Hasan) Uka, Naim (Bislime) Osmani, Nysret (Hasan) Sahiti, Nezir (Xhevat) Halimi, Osman (Isuf) Sahiti, Pajazit (Muhamet) Tahiri, Rafet (Qazom) Behrami, Remzi (Kadri) Kurteshi, Ruzhdi (Kajtaz) Kurteshi, Rexhep (Xhemajl) Pllana, Rushit (Hysen) Vidishiqi, Rabiye (Shyqyri) Isufi, Rexhep (Januz) Qitaku, Rushit (Rrustem) Rushiti, Rrahim (Sherif) Istrefi, Sejdi (Dulë) Hajrizi, Sadije (Hasan) Begiqi, Sadik (Murat) Beqiri, Safet (Ramadan) Hyseni, Sahit (Rushit) Barani, Selajdin (Mustafë) Mehmeti, Salih (Bajram) Hasani, Smajl (Bajram) Uka, Sebastian (Xhafer) Mehmeti, Sadete (Xhafer) Mehmeti, Selime (Hajdar) Kaçanolli, Sadete (Hazir) Feka, Sami (Hazir) Feka, Sami (Skender) Hasani, Suad (Nesad) Hoxha, Samir (Selim) Berisha, Selim (Nazmi) Berisha, Shahin (Shefqet) Maxhuni, Shaip (Halil) Ujkani, Shaban (Bajram) Qosa, Shkëlzen (Sadri) Ujkani, Shpresa (Adem) Deliu, Shaqir (Isuf) Peci, Ukë (Sadik) Rexhepaj, Veton (Ismajl) Gërdoci, Vullnet (Hazir) Rama, Vehbi (Ismajl) Zasella, Violeta (Bajram) Peci, Zojë (Rrahim) Behrami, Zylë (Ramë) Hasani, Zymer (Osman) Mëziu, Zyle (Niman) Dajakaj, Zahide (Hasan) Beqiri. (Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar...*, f. 252-254).

Gjakovë apo Prishtinë, ngase nuk kemi asnjë organizatë me qendër në Mitrovicë që merret me këto kategori.²⁸

Dëbime, zhvendosje e dhunshme dhe përndjekje

Në Tribunalin për Krime Lufte në Hagë, dëshmitarët kanë dëshmuar edhe për tri kategori të ndryshme të krimeve dhe gjenocidit të forcave serbe në komunën e Mitrovicës: dëbim, zhvendosje e dhunshme dhe përndjekja e shqiptarëve. Sipas dëshmitarëve, të cilët kanë dëshmuar në Tribunalin e Hagës,²⁹ gjatë fundit të muajit mars dhe mesit të prillit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të lëviznin sistematikisht nëpër qytetin e Mitrovicës. Ato forca hynin në shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës dhe i urdhëruan banorët që t'i lëshonin menjëherë shtëpitë dhe të shkonin në stacionin e autobusëve. Shtëpitë digjeshin, banorët detyroheshin të iknin në lagje të tjera të qytetit. Gjatë një periudhe disa avore, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vazhduan të dëbonin banorët shqiptarë të qytetit. Gjatë kësaj periudhe, objektet që ishin pronë e shqiptarëve u shkatërruan. Shqiptarëve iu grabitën të holla, automjete dhe artikuj të tjerë me vlerë, kurse gratë shqiptare u dhunuan seksualisht.

Një praktikë e ngjashme u zbatua në fshatrat e tjera të komunës së Mitrovicës ku forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i dëbuan shqiptarët nga shtëpitë dhe i shkatërruan fshatrat. Banorët shqiptarë të kësaj komune u detyruan t'u bashkoheshin kolonave drejt kufirit me Shqipërinë duke kaluar përmes qyteteve Skënderaj, Pejë, Gjakovë dhe Prizren. Gjatë rrugës për në kufi, oficerët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë iu grabitën shqiptarëve artikuj me vlerë dhe ua konfiskuan letërnjoftimet. Dëbimi, zhvendosja e përndjekja bëhej me masa represive, me dhunë e terror, me ekzekutime e metoda të tjera terroriste. Sipas Afërdita Hajrizit, natën e 24-25 marsit 1999, gjashtë burra me uniforma kamuflimi ngjyrë të kaltër të mbyllët dhe me bereta të zeza, erdhën me dy makina në shtëpinë e saj. Ata hynë me forcë në shtëpi dhe vranë burrin, djalin, dhe vjehrrën e saj, kurse ajo u fsheh në tavan me dy fëmijët e tjerë. Sipas saj, si pasojë e këtij terrori, më 28 mars 1999, 70 000 banorë të qytetit të Mitrovicës u detyruan të largoheshin nga shtëpitë. Kurse dëshmitari tjetër, avokatit Mahmut Halimi, më 14 prill 1999, rreth orës 10:00, i kishte parë me sy forcat serbe me autobllinda, të cilit i afroheshin fshatit dhe kishin hapur zjarr drejt tij nga drejtimi i Suhadollit, i cili gjendet në veri. Për këtë arsye, ai dhe familja e tij udhëtuan përgjatë lumit në Zhabarin e Epërm. Të nesërmen në mëngjes, nga shtëpia ku ndodheshin,

²⁸ Nafi Krasniqi, *Shoqata "Drejtësi për të gjithë"*, Prishtinë, 20.02.2021.

²⁹ Mahmut Halimi, Afërdita Hajrizi dhe Sadije Sadiku nga Mitrovica.

Halimi pa shumë njerëz duke ardhur në këmbë nga Suhadolli, Lagjja “Tavnik” e Mitrovicës dhe Shipoli. E gjithë kjo shihej nga pika ku ishte ai. Njerëzit që vinin nga Zhabari i Poshtëm i thanë se forcat serbe po i dëbonin banorët e këtyre fshatrave. Më tutje ai kishte dëshmuar se si pasojë e këtij terrori, nga ajo që kishte parë vetëm në ato lagje, ishte formuar një kolonë me rreth 25 000-30 000 vetë, e cila u nis në drejtim të jugut përgjatë rrugës kryesore nga qyteti i Mitrovicës për në Shipol.³⁰ Sipas të dhënave që posedon KLMDNJ-Qendra Rajonale në Mitrovicë, gjatë luftës 1998/99, nga Komuna e Mitrovicës, nga forcat serbe u dëbuan me dhunë mbi 80 000 shqiptarë.³¹

Edhe Dhoma Gjyqësore e Tribunalit të Hagës kishte konkluduar se me fillimin e sulmeve ajrore të NATO-s, shqiptarë e shquar të Mitrovicës u ndoqën dhe disa prej tyre u vranë. Po ashtu, forcat e MPB-së dëbuan mijëra shqiptarë nga disa pjesë të qytetit, disa prej të cilëve u dërguan në Mal të Zi. Me këtë rast ishte konkluduar se në mesin e prillit 1999, shumë shqiptarë nga Zhabari dhe fshatrat e afërta, së bashku me të tjerë që ishin strehuar aty, u dëbuan nga forcat e MPB-së dhe UJ-së prej shtëpive të tyre dhe u detyruan të largoheshin nga Kosova. Shumë nga këta njerëz u detyruan të ecnin disa ditë deri në kufi pa ushqime dhe ujë. Gjatë rrugës deri në kalimin kufitar, pjesëtarët e kolonës u plaçkitën dhe u keqtrajtuuan nga policia dhe forcat me uniformë që bashkëvepronin me policinë. Me të arritur në kufi, policia detyroi shumë nga njerëzit e dëbuar që të dorëzonin dokumentet personale, të cilët nuk iu kthyen.³²

Varrezat masive në Mitrovicë

Në Komunën e Mitrovicës janë zbuluar disa varreza masive. Një varrezë masive është gjetur në mes të fshatrave Suhodoll dhe Vidimriq. Në këtë varrezë janë gjetur 31 trupa të pajetë të shqiptarëve, zhvarrimi i të cilëve është bërë nga hetuesit e Tribunalit të Hagës, më 25, 26 dhe

³⁰ Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991, Lënda Nr. IT-05 87-T, Data: 26 shkurt 2009, Aktgjykimi 2-4, f. 252, 255, 257, 259;

http://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/sq/090226_vol3.pdf, qasja, 07.05.2020.

³¹ Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar...*, f. 284.

³² Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991, Lënda Nr. IT-05 87-T, Data: 26 shkurt 2009, Aktgjykimi 2 prej 4, f. 26, 264;

http://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/sq/090226_vol3.pdf, qasja, 7.05.2020.

27.IX.1999. Gjatë këtij zhvarrimi ka asistuar edhe kryetari i KLMDNJ-Qendra Rajonale në Mitrovicë, Halit Barani. Me këtë rast janë identifikuar trupat e 21 shqiptarëve të vrarë. Të gjithë këta janë pushkatuar më 14.IV.1999 në Lagjen “Bair”, “Kuarti i Kovaçëve” në Mitrovicë, me përjashtim të njërit dhe janë varrosur në varrezat e fshatit Shupkoc. Varrezë tjetër është edhe ajo në fshatin Vërnice-Mitrovicë, ku janë gjetur 5 trupa të pajetë. Tre prej tyre janë rivarrosur në fshatin e tyre të lindjes Koprivë, kurse dy trupa nuk janë identifikuar dhe janë dërguar në morgun e Rahovecit. Tre prej tyre janë pushkatuar më 20.V.1999, pastaj janë masakruar.

Një varrezë tjetër masive është zbuluar në varrezat e fshatit Vaganicë. Aty, më 30.IX.1999, janë zhvarrosur 8 trupa të pajetë të shqiptarëve të pushkatuar nga forcat serbe më 16.IV.1999, në Lagjen “Ura e Gjakut”. Varrezë masive është zbuluar edhe në fshatin Suhodoll më 3 dhe 4.X.1999. Fillimisht është identifikuar vetëm një person, kurse pas tri vjetësh janë identifikuar edhe 71 trupa të pajetë nga komuna e Skënderajt. Më 05.X.1999, në varrezat e fshatit Gushafc, ishte zbuluar edhe një varrezë masive. Aty janë pushkatuar më 20.V.1999. Nga 7 sa ishin gjithsej, 4 prej tyre janë identifikuar, kurse 3 të paidentifikuar të tjerë janë dërguar në morgun e Rahovecit. Në varrezën masive, e cila ka qenë në varrezat e qytetit të Mitrovicës, ku më 08.X.1999 është bërë zhvarrimi i trupave të pajetë, 6 prej tyre janë identifikuar dhe rivarrosur, kurse të tjerët janë dërguar në morgun e Rahovecit për identifikim. Në varrezën masive të gjetur në fshatin Zhabar i Poshtëm të Mitrovicës, më 12.X.1999, është bërë zhvarrimi i 7 trupave të pajetë, 4 prej tyre janë identifikuar, kurse 3 të tjerë janë dërguar për identifikim në morgun e Rahovecit. Në vazhden e varrezave masive është zbuluar edhe një varrezë tjetër masive në fshatin Zhabar i Poshtëm, më 08.IX.2002. Aty janë zhvarrosur e më pas rivarrosur 7 trupa të pajetë, kurse për 2 trupa të tjerë nuk është zbuluar identiteti. Në varrezat e fshatit Shupkoc, ku është zbuluar një varrezë tjetër masive, më 08.X.1999, është bërë zhvarrimi i disa trupave të pajetë. Me këtë rast është bërë vetidentifikimi i tyre.³³

Krimi dhe etnocidi kulturor dhe fetar

Në komunën e Mitrovicës janë djegur dhe dëmtuar 22 shkolla, 10 prej të cilave janë rrafshuar me themel.³⁴ Forcat serbe dogjën dhe rrafshuan me tokë objekte të rëndësishme kulturore: kompleksin e ndërtesave të

³³ Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar...*, f. 379-382.

³⁴ Jusuf Osmani, *Krimet serbe në Kosovë 1998-1999*, Libri 1, Prishtinë, 2010, f. 547-550.

Çarshisë së vjetër, shumë shtëpi e kulla të vjetra me vlerë historike e arkitektonike, teqe, varre e përmendore. Forcat serbe kanë dëmtuar edhe kishën katolike shqiptare si dhe shumë objekte të tjera.³⁵ Gjithashtu, në Mitrovicë, forcat serbe kanë djegur edhe objekte kulturi (xhami). Më 2 maj 1999, është djegur tërësisht Xhamia e Ibrit në Mitrovicë dhe është bërë rrafsh me tokë duke mos lënë asnjë gjurmë. Xhamia Isa Beg është djegur nga brenda, Xhamia e Haxhi Veselit, Xhamia e Bajrit, Xhamia e Shipolit janë demoluar, Xhamia e Zhabarit të Poshtëm është djegur pjesërisht nga brenda, Xhamia e Barës është djegur nga brenda, Xhamia e Koshtovës së Bobit është djegur tërësisht, Xhamia e Vllahisë është demoluar, Xhamia e Dedisë është djegur tërësisht.³⁶

Vjedhja, dëmtimi dhe shkatërrimi i fondit arkivor shton përmasën e krimit të Serbisë në Kosovë. Fonde të shumta arkivore janë marrë, por edhe janë djegur e shkatërruar nga Serbia edhe në Mitrovicë. Ato vjedhje, dëmtime e shkatërrime shtrihen në disa institucione, në disa nivele. Arkivi Historik Rajonal i Mitrovicës, nga viti 1985, ka qenë i vendosur në katin e parë të Qendrës së Kulturës “Rexhep Mitrovica”. Aty, në qershor 1999, vendoset KFOR-i francez, i cili nuk ka lejuar hyrjen në objekt as të punonjësve të këtij institucioni deri më 31.10.2001. Komisioni i formuar nga Arkivi ka bërë kontrollimin e dokumentacionit arkivore nëpër regjistratura dhe ka konstatuar:

-Ofiqarisë së Mitrovicës i mungojnë: librat e të lindurve, të kurorëzimit dhe të nënshtetësisë në periudhën kohore 1900-1999; i mungojnë edhe librat për evidencim të të vdekurve (1997-1999); i mungojnë 452 libra dhe 558 kuti arkivore. Më konkretisht mungojnë: 47 regjistra amë të të lindurve të periudhës 1900-1997; 228 libra amë të të lindurve (1921-1997); 72 regjistra, libra amë të kurorëzimit (1914-1997); 49 libra amë të të vdekurve (1913-1997); 31 libra amë të nënshtetësisë (1948-1997); 22 libra të tjerë; 533 kuti arkivore me lëndët e paraqitjeve për regjistrim, kurorëzim, vdekje, ndërrim i emrave dhe mbiemrave (1900-1997). Në *zyrat e vendit*: Bare, Vllahi, Stantërg, Tuneli i Parë, Shipol dhe Shupkovic janë marrë nga okupatori serb të gjitha librat e lindjes, kurorëzimit dhe nënshtetësisë. Dokumentacioni i zyrate të vendit është tërhequr gradualisht nga okupatori në mënyrë të organizuar. Ky dokumentacion është tërhequr dhe është dërguar nga forcat serbe në qytetin e Krlevës dhe të Krushvecit. Në *Arkivin e Komunës*, ende nuk dihet sasia e dokumentacionit që mungon, kurse Shërbimi i Kadastrës, i cili arkivin e vet,

³⁵ Mitrovica me rrethinë-Mozaik informativ, Mitrovicë, 2000, f. 73.

³⁶ Bashkësia Islame e Kosovës, *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë* (shkurt 1998-qershor 1999), Prishtinë, 2000, f. 53-64.

dokumentacioni është marrë e dërguar në qytete e Krlevës dhe Krushevcit.³⁷

Në Muzeun e Qytetit të Mitrovicës janë vjedhur librat e evidencës, janë vjedhur vulat, janë plaçkitur shumë ekspozate të rëndësisë së veçantë me vlera të pallogaritshme. Objekti është doemoluar plotësisht, janë dëmtuar vitrinat dhe dyert e hyrjes. Në Muzeun e Qytetit të Mitrovicës, gjatë masave të dhunshme 1990-1999, në mënyrë të organizuar janë marrë: librat e inventarit të arkeologjisë, etnografisë dhe historisë. Ka të dhëna të sakta se librat gjenden në pjesën veriore të Mitrovicës.³⁸

Marrja, djegia dhe shkatërrimi i dokumentacionit në shkollat e Mitrovicës me rrethinë

Forcat serbe nuk i kanë kursyer as personelin arsimor, as nxënësit e shkollave të mesme dhe fillore dhe as dokumentacionin. Sipas të dhënave arkivore dhe raporteve të burimeve të ndryshme, në komunën e Mitrovicës janë marrë, dëmtuar por edhe djegur e shkatërruar dokumente të shumë shkollave dhe institucione tjera. Në Fakultetin Xehetaro-Metalurgjik në Mitrovicë, janë marrë: 1 700 fashikuj e 12 regjistratorë lëndë arkivore të periudhës 1991-1999. Në shkollat e mesme të komunës së Mitrovicës janë marrë, djegur dhe zhdukur dokumente të shumta. Në Gjimnazin “Frang Bardhi”, në qershor të vitit 1999 janë djegur: librat amë, ditarët e mësimit, dosjet e punëtorëve dhe dokumentacioni financiar (1991-1999). Në SHME “Hasan Prishtina”, janë marrë librat amë, ditarët e mësimit, dosjet e punëtorëve, dokumentacion financiar dhe shkresa të tjera të shumta në periudhës 1990-1999. Në SHMM “Xheladin Deda” mungojnë librat amë, një pjesë e ditarëve të mësimit dhe dokumentet financiare (1987-1999). Në SHMT “Arkitekt Sinani” mungon tërë dokumentacioni i drejtimeve të Xehetarisë, Kimi-Biologji, Gjeologji dhe Metalurgji (1990-1999). Në Shkollën e Mesme Speciale “Nënë Tereza” janë marrë 100 libra e 11 regjistratorë të (1986-1999).³⁹ Forcat serbe nuk e kanë kursyer as dokumentacionin e shkollave fillore. Në SHF “Meto Bajraktari” mungojnë: 100 libra, 200 fascikulla (fashikuj) e 50 regjistratorë” (1945-1999); në SHF

³⁷ Agjencia e Arkivave të Kosovës, Dosja: Dëmet e luftës; *Raport i Arkivit historik rajonal në Mitrovicë mbi gjendjen e dokumentacionit në arkiv dhe në regjistratura 1989-1999, shtator 2003.*

³⁸ Agjencia e Arkivave të Kosovës, Dosja: Qeveria e Kosovës-Komisioni për vlerësimin e dëmeve, 1989-1999, *Dëmet e shkaktuara gjatë administrimit të dhunshëm serb në institucionet e Kulturës në Kosovë gjatë viteve 1989-1999*, nr.373/04, datë 12.03.2004.

³⁹ AAK, Dosja: Dëmet e luftës; *Raport i Arkivit historik rajonal në Mitrovicë mbi gjendjen e dokumentacionit në arkiv dhe në regjistratura 1989-1999, shtator 2003.*

“Sylejman Vokshi” në Broboniq mungojnë: 20 fashikuj dhe 100 ditarë mësimi, të cilët janë djegur nga policia e ushtria serbe më 20.05.1999 (1975-1985), ndërkaq në SHF “Habib Jusufi” në Vllahi, mes 1 dhe 2 majit 1999 janë djegur nga forcat serbe 200 ditarë mësimi, dosjet e punëtorëve, 30 regjistratorë, 40 fashikuj dhe shkresa të tjera (1943-1999). Edhe në SHF “1 Maji” në Shupkovc janë marrë: 100 libra, 30 fashikuj e 45 regjistratorë (1986-1999), kurse në SHF “Osman Rama” në Çabër, gjatë muajve prill-qershor 1999, është djegur tërë dokumentacioni (1952-1999). Më tutje, në SHF “Isa Boletini” në Boletin dhe në paralelen e saj në Zhazhë, janë djegur: 50 libra, 40 fashikuj e 30 regjistratorë (1972-1999). Në SHF “Bislim Hajdari” në Kaçanoll, gjatë ofensivës së 15-18 shtatorit 1998 janë djegur: 600 libra, 100 fashikuj e 120 regjistratorë (1945-1999). Në SHF “Rifat Vidishiqi”, në të njëjtën ofensivë, janë djegur: 400 libra, 40 fashikuj e 20 regjistratorë (1945-1999). Në muajin prill 1999, në SHF “Elena Gjika”, është djegur gjithë dokumentacioni i periudhës 1991-1999. Nuk është kursyer as SHF “Bajram Curri”, të cilës i mungojnë: 730 libra, 30 regjistratorë (1946-1999).

Sa i përket SHF “Andon Z.Çajupi”, në muajin prill 1999, ka dy të dhëna. Diku thuhet se nga forca serbe janë djegur: 30 fashikuj e 20 regjistratorë, kurse diku tjetër thuhet se është djegur krejt dokumentacioni. Edhe sa i përket periudhës kohore të cilit i ka takuar dokumentacioni ka dy të dhëna: diku thuhet se i ka takuar periudhës 1908-1999 e diku 1991-1999. Në SHF “Migjeni” në Mitrovicë, nga forcat serbe janë djegur: 400 libra; dosjet e punëtorëve, 120 regjistratorë, dokumente financiare etj.; 160 metra dokumente e 62 fashikuj dokumentacione (1983-1999). Në SHF “Bedri Gjinaj”, në maj të vitit 1999, është shkatërruar fondi bibliotekar. Në prill 1999, në SHF “Avdullah Shabani”, janë djegur 180metra lëndë arkivore (dokumente) të periudhës 1961-1999. Edhe në SHF “Ismail Qemajli” janë asgjësuar 2 metra lëndë arkivore të periudhës 1990-1999. Për SHF “Skënderbeu”, në prill-maj 1999, thuhet se janë djegur 3 metra lëndë arkivore të periudhës 1985-1999. Në SHF “Qazim Bajgora” (tani “Mehë Uka”), në prill-maj 1999 është djegur i tërë dokumentacioni i shkollës i periudhës 1945-1999; në SHF “Sefedin Smakolli” në Rashan, në prill-maj 1999, është djegur dokumentacioni (1945-1999); në SHF “Riza Voca” në Zabërgjë, në ofensivën e shtatorit 1998, bashkë me objektin e shkollës është djegur gjithë dokumentacioni (1955-1998); në SHF “Jusuf Rexha” në Koshtovë, në prill 1999, është djegur gjithë dokumentacioni (1991-1999); në SHUM “Tefta Tashko” është dëmtuar shumica e dokumentacionit (1990-1999); në SHF “Fazli Grajçevci” në Shipol është shkatërruar shumica e dokumentacionit në shkollën amë, ashtu edhe në paralelet e saj në Zhabar dhe Vërnice (1990-1999); në SHF “Trepça” në Stantërg, në prill 1999, janë

djegur dosjet e punëtorëve të shkollës amë në Trepçë, kurse i tërë dokumentacioni në paralelet e ndara në Mazhiq dhe Melenicë (bashkë me objektet). Një dëm e krim kolosal arsimit të Mitrovicës i është bërë nga forcat serbe duke ia shkatërruar e djegur edhe dokumentacionin e Këshillit Komunal të Arsimit në Mitrovicë të periudhës kohore 1992-1999. Ka të dhëna se kjo ka ndodhur në prill të vitit 1999. Më konkretisht janë djegur: dosjet e të gjithë punëtorëve të arsimit fillor dhe të mesëm të Mitrovicës, 20 regjistratorë, 30 fashikuj, dokumentacioni financiar dhe shkresa të ndryshme. Në Qendrën e Kulturës “Rexhep Mitrovica”, një sasi e dokumentacionit (dosjet e punëtorëve dhe dokumentacioni tjetër financiar) është bartur në mënyrë të organizuar nga pala serbe në prill-qershor 1999. Gjatë renovimit të objektit, atëherë kur KFOR-i ishte i vendosur aty (nga 1999-2001), është bartur diku dhe nuk dihet ku është dërguar. KLMDNJ ka të dhëna se më 27.10.1999 është plaçkitur tërë dokumentacioni i Entit Pedagogjik për shkollat fillore dhe të mesme (1991-1999).⁴⁰

Dëmet e shkaktuara në rrjetin e bibliotekave

Janë djegur 6 biblioteka publike me 100 000 libra.⁴¹ I tërë dokumentacioni i Bibliotekës Ndërkomunal “Latif Berisha” në Mitrovicë është marrë dhe është dërguar në pjesën veriore të Mitrovicës. Janë djegur rreth 175 000 libra të bibliotekave personale të intelektualëve të Mitrovicës. Bashkë me objektet shkollore janë djegur 18 biblioteka të shkollave fillore me një fond prej 63 000 librash. Po ashtu janë djegur nëndegët e bibliotekave në fshatrat Vllahi e Bare në një fond prej 18 389 libra; janë vjedhur 500 libra të nëndegës së bibliotekës në Tunelin e Parë bashkë me dy tavolina dhe 10 karrige.

Në Bibliotekën Ndërkomunale “Latif Berisha” në Mitrovicë janë marrë 230 fjalorë dhe enciklopedi, 150 libra të fushës së mjekësisë; 1 kompjuter, 1 aparat fotokopjues, dy telefona, 1 faks dhe rreth 50 tavolina, karrige dhe orendi të tjera. Gjithashtu, forcat serbe në Mitrovicë kanë djegur edhe qindra biblioteka të pasura të individualiteteve krijues të shkencës e kulturës shqiptare, me mbi 200 mijë libra, shumë vepra në dorëshkrim të autorëve dhe fushave të ndryshme, vepra të gjinisë së artit, si: piktura, skulptura, grafika etj.; veshje të ndryshme kombëtare që paraqesin thesar të

⁴⁰ AAK, Dosja: Dëmet e luftës; *Raport i Arkivit historik rajonal në Mitrovicë mbi gjendjen e dokumentacionit në arkiv dhe në regjistratura 1989-1999, shtator 2003.*

⁴¹ Jusuf Osmani, *Krimet serbe në Kosovë, 1998-1999*, Libri 1, Prishtinë, 2010, f. 547-550.

begatshëm nga fusha e etnografisë, shumë vegla muzikore, artizanati, enë të vjetra, dokumente të kashta me vlerë arkivore etj.⁴²

Dëmet e shkaktuara në lëmin e sportit

Njësitë kriminale të ushtrisë, policisë, formacioneve speciale, masave të dhunshme dhe organizmave të tjera të pushtetit serb nuk e kanë kursyer as sportin. Dëmet janë të mëdha. Këto dëme ekspertët i kanë klasifikuar në dëme indirekte dhe dëme direkte. Në dëmet indirekte përfshihen resurset njerëzore dhe menaxhimi i dobët. Kësisoj, palestra e sporteve në Mitrovicë, fusha e sporteve të vogla, stadiumi i ri i futbollit, stadiumi ndihmës, stadiumit të vjetër “Liria” i janë shkaktuar dëme: 41 000 euro në resurse njerëzore (paga etj.) dhe 143 000 euro shkaku i menaxhimit të dobët. Dëmet direkte lidhen me shkatërrimin e infrastrukturës që arrin vlerën e 147 000 euro. Totali i dëmeve në sport arrin 331 400 euro.⁴³

Sigurimi pensional

Rajoni i Mitrovicës, sipas dokumenteve arkivore, ka pasur 17 533 pensionistë, respektivisht 19.6 % të numrit të përgjithshëm. Nga ky numër 10 613 kanë qenë të përkatësisë kombëtare shqiptare, plus të tjerë (turq, ashkali etj.). Bazuar në analizat e ndryshme që janë bërë nga Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Kosovës dhe komisioneve qeveritare bëhet fjalë për dëme milionëshe. Sipas ekspertëve, dëmi i shkaktuar për vitin 1998 kap shifrën prej 2 660 738 €. Pensionet e pa paguara gjatë vitit 1999 në rajonin e Mitrovicës arrijnë vlerën 8 869 128 €. Pra, dëmi i përgjithshëm i llogaritur për vitet 1998-1999 për rajonin e Mitrovicës arrin rreth 11 529 866 €. Mirëpo, duhet pasur parasysh se revalorizimi dhe norma e kamatave nuk janë përlllogaritur fare gjatë përpunimit të këtyre shënimeve, që rrjedhimisht nënkupton se dëmet e shkaktuara ndaj kategorisë së pensionistëve janë shumëfish më të larta.⁴⁴

⁴² Mitrovica me rrethinë-Mozaik informativ, 2000, f.73; AAK, Dosja: Dëmet e luftës; *Raport i Arkivit historik rajonal në Mitrovicë mbi gjendjen e dokumentacionit në arkiv dhe në regjistratura 1989-1999, shtator 2003.*

⁴³ AAK, Dosja: UNMIK-Institucionet e Përkohshme të Qeverisjes-Departamenti i Sportit, *Raport i vlerësimit të dëmeve para dhe gjatë luftës, Prishtinë, 17.03.2003.*

⁴⁴ AAK, Dosja: Qeveria e Kosovës-Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga pushteti i Serbisë në Kosovë në periudhën kohore 1989-1999; *Pensionet e papaguara pensionistëve kosovarë*, nr.1376/3, 200; *Elaborat i Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës së Kosovës mbi cenimin e së drejtës së pensionistëve dhe invalidëve të punës së Kosovës dhe diskriminimi e mohimi i kësaj të drejte nga Serbia*, nr.16, 7 prill 2003, Prishtinë, kryetari Fazli Kajtazi.

Arrestime, burgosje dhe dënime me burg

Një terror i vazhdueshëm që ka zgjatur me dekada kundër shqiptarëve ishte arrestimi, burgosja dhe dënimi i qindra shqiptarëve të Mitrovicës. Pra, ashtu siç është e gjatë lista e të vrarëve, të zhdukurve dhe të plagosurve po ashtu është e gjatë edhe lista e të burgosurve të Mitrovicës nga forcat serbe. Përveç Gani (Aziz) Baliut, i cili ka vuajtur burg nga 1982-1986 dhe 26.01.1997-3.04.2001, Ismajl (Bajram) Smakiqit, i cili ka vuajtur burg në periudhën kohore 1981-1984 dhe Raif (Brahim) Qelës, i cili ka qenë i dënuar me burg në vitet 1981 dhe 1984-1990 dhe 1997-2001 etj., numri më i madh i të burgosurve përfshinë periudhën 1998-1999.⁴⁵

⁴⁵ Agim (Ajet) Peci, Agron (K) Pllana, Arben (Ramadan) Uka, Aziz (Zukë) Neziri, Abit (Ahmet) Dibrani, Asmir (Arif) Murati, Abedin (Rrustem) Hyseni, Adem (Salih) Hasani, Arsim (Skender) Hajdari, Azem (Milazim) Fazliu, Afrim (Ahmet) Jashari, Abedin (Ferat) Ferati, Adem (Muharrem) Shala, Ali Ahmeti, Abedin (Hashim) Halimi, Avni (Aziz) Hyseni, Avdyl (Beqir) Beqiri, Astrit (Sheremet) Beka, Azem (Arif) Osmani, Avdi (Halim) Osmani, Ahmet (Fejzë) Hajrizi, Avdyl (Jahir) Hajdini, Asllan (Haxhi) Abazi, Avdyl (Fetah) Azemi, Arsim (Kamer) Zeneli, Asllan (Hasan) Behrami, Agim (Hashim) Trepça, Afrim (Isuf) Gruda, Adem (Avdi) Hasani, Agim (Gani) Hasani, Albert (Agim) Hasani, Besim (Zymer) Brahimi, Bahri (Ramiz) Istrefi, Behxhet (Kamer) Zeneli, Besim Rama, Beqir (Tahir) Beqiri, Bashkim (Bajram) Pllana, Burim (Ramadan) Uka, Bajram (Hashim) Salihu, Besim (Sinan) Baliu, Blerim (Skender) Hajdari, Bekim (Hajriz) Kabashi, Behram (Halil) Behrami, Bislim (Ramiz) Selimi, Bedredin (Faik) Pllana, Bahri (Nexhmedin) Ferizi, Bahri (Ramiz) Istrefi, Bashkim (Ramadan) Gllgovci, Bedri (Hajdar) Ferati, Bashkim (Kurtesh) Pllana, Burim (Xhemjl) Berisha, Besim (Imer) Asllani, Ibrahim (Hasa) Uka, Behxhet (Xhevat) Voca, Berat (Bilall) Rama, Beqir (Avdyl) Ferati, Basri (Emin) Ferati, Bajram (Hasan) Uka, Besim (Ramadan) Tahiri, Burim (Jashar) Prekazi, Bashkim (Ukshin) Fetahu, Bashkim (Murat) Hyseni, Bali (Hysen) Hajra Behram (Sahit) Behrami, Ibrahim (Mustafë) Mustafa, Bilall (Miftar) Jashari, Bedri (Sherif) Qerimi, Driton (Idriz) Rushiti, Demir (Ali) Hasani, Daut (Mehmet) Rrahmani, Demir (Zeqir) Rexhepi, Enver (Sherif) Ahmeti, Esat (Gani) Jashari, Enver (Ymer) Munishi, Esat (Rasim) Jashari, Enver (Asllan) Imeri, Esat (Mehmet) Gashi, Esat (Sylejman) Misini, Enver (Mursel) Hajra, Ejup (Fazli) Fazliu, Elez (Zeqir) Hoti, Enver (Shaban) Tahiri, Enver (Sahit) Dubreva, Ejup (Rexhep) Avdiu, Enver (Hamit) Xhemajli, Enver (Azem) Selani, Ekrem (Bajram) Avdiu, Fahri (Feriz) Berisha, Fehmi (Rrahman) Jashari, Fuat (Vehbi) Buçinca, Fehmi (Emin) Pllana, Fitim (Kurtesh) Pllana, Ferat (Bislim) Kadriu, Faton (Ilaz) Abazi, Fehmi (Hasan) Prokoshi, Fazli (Ramadan) Sadriu, Fazli (Bislim) Aliçkaj, Fejzullah (Hasan) Ibrahim, Fejzullah (Qamil) Peci, Faik (Vesel) Fazliu, Fatmir (Sejdi) Bajrami, Ferid (Abit) Zeneli, Fatmir (Shyqyri) Gjinovci, Fatmir (Bahri) Berisha, Feriz (Hetem) Zeqiri, Fazli (Sahit) Avdiu, Fazli (Emin) Avdiu, Fidan (Gani) Kelmendi, Fekë (Hashim) Feka, Fahri (Hysen) Gashi, Fazli (Sefer) Sylja, Fitim (Faik) Uka, Feriz (Hajriz) Zeqiri, Ferki (Hasan) Uka, Gani (Haxhi) Hoxha, Gazmend (Kadri) Gjinovci, Gani (Bejtullah) Shkupolli, Gani (Jahir) Muja, Gani (Aziz) Baliu, Gani (Xhemajl) Asllani, Gani (Rexhep) Rama, Gani (Tahir) Isufi, Gani (Deli) Xhafa, Gëzim (Nazmi) Arifi, Hysen (Bajram) Sadiku, Haki (Rrahman) Kerolli, Hajdin (Haxhi) Balija, Hakif (Rifat) Latifi, Haki (Ramadan) Qitaku, Halil (Rexhep) Abazi, Haxhi (Sadri)

Ferizi, Hajrudin (Rrahim) Ferati, Hajriz (Ragip) Bislimi, Hysen (Bajram) Ferizi, Hevzi (Avdyl) Lecaj, Halit (Xhemajl) Xhema, Hajrush (Avdyl) Hasani, Hilmi (Musli) Hasani, Halil (Hasan) Hasani, Halit (Jetish) Kelmendi, Hakif (Ali) Beqiri, Hamdi (Nebih) Salihu, Halit (Avdi) Qitaku, Hamdi (Hazir) Parduzi, Halil (Sylejman) Delija, Hazir (Sali) Peci, Hajrullah (Jetullah) Peci, Hysni (Ali) Ibushi, Hasan (Jashar) Ferati, Habib (Behxhet) Beka, Hysni (Sejdi) Bekteshi, Hafiz (Abit) Peci, Hashim (Sherif) Bajraktari, Hasan (Isuf) Prokshi, Hajdin (Hasan) Krasniqi, Halim (Qazim) Xhafa, Hajriz (Munish) Asllani, Hamdi (Ali) Sejdiu Hazir (Avdyl) Bekteshi, Halil (Avdullah) Nura, Ismajl (Bajram) Smakiqi, Idriz (Halit) Asllani, Idriz (Hajdar) Zhilivoda, Imer (Bislim) Haziri, Ismet (Rifat) Pllana, Isak (Rasim) Aliu, Isa (Adem) Hasani, Idriz (Murat) Spahiu, Ilaz (Sadik) Abazi, Ismet (Jetullah) Ademi, Ismet (Qerim) Xhafa, Ismet (Hamëz) Smakiqi, Ismet (Hashim) Halimi, Imer (F) Imeri, Ismet (Mehmet) Osmani, Istref (Avdi) Ferati, Ismail (Kamer) Qerimi, Isuf (Ilaz) Cerroviku, Idriz (Adem) Thaqi, Ismet (Xhemajl) Prokshi, Ismet (Muharrem) Krasniqi, Isak (Rasim) Aliu, Isuf (Miran) Hasani, Ilir (Sali) Muhadri, Ilmi (Halil) Haliti, Izet (Bajram) Ferizi, Ibish (Vesel) Kajtazi, Istref (Fejzë) Jashari, Ilmi (Rahman) Kerolli, Izet (Mehmet) Imeri, Imet (Mujë) Geci, Isuf (Hashim) Hashimi, Ismajl (Jashar) Pajaziti, Jonuz (Sadik) Gashi, Jashar (Rrustem) Prekazi, Jahir (Alush) Demaku, Jusuf (Rizah) Spahija, Jahir (Bejtë) Bejta, Jetish (Nebih) Salihu, Jeset (Alush) Hoti, Jakup (Hajriz) Isufi, Kadri (Sadri) Zeneli, Kemal (Reshat) Vinarci, Kamer (Jakup) Mehmeti, Kadri (Hajdin) Peci, Kadri (Hamit) Bekteshi, Kajtaz (Sylë) Rushiti, Luan (Ramiz) Kosova, Latif (Smajl) Smajli, Lufi (Bajram) Voca, Lavdim (Jashar) Prekazi, Latif (Qazim) Musliu, Lulzim (Refik) Beka, Lavdim (Bilall) Behrami, Mehdi (Qazim) Pllana, Mursel (Alush) Shala, Mehmet (Fazli) Imeri, Musa (Ramadan) Tahiri, Mazllum (Isak) Gashi, Mehmet (Hashim) Kadriu, Muhamet (Qamil) Berisha, Mursel (Qemail) Aliu, Murat (Selamn) Ademi, Muhamet (Hysen) Babaj, Musa (Miran) Muja, Muharrem (Hajzer) Musliukaj, Musa (Avdyl) Musa, Miftar (Miran) Abazi, Maliq (Avdi) Ferizi, Musa (Ahmet) Uka, Metë (Januz) Hodaj, Muhamet (Haxhi) Abazi, Miftar (Xhemajl) Bajrami, Munish (Sherif) Munishi, Mursel (Hisen) Tahiri, Naim (Misim) Babaj, Nexhat (Idriz) Syla, Naser (Shaqir) Selimi, Nexhat (Sokol) Shabani, Naim (Sefedin) Munishi, Nezir (Halim) Avdyli, Nazmi (Isak) Bunjaku, Naim (Raif) Dauti Nasuf (Bajram) Tahiri, Naim (Nezir) Suma, Naim (Hazir) Peci, Nexhip (Hysen) Kabashi, Nexhat (Sejdi) Brahimi, Nuhi (Sali) Jonuzi, Nexhmedin (Hetem) Llahusha, Naim (K) Pllana, Nehat (Xhemajl) Xhemajli, Nexhat (Hashim) Xhafa, Nazmi (Hakif) Arifi, Nasuf (Alush) Miftari, Nazmi (Mujë) Broboniqi, Nazmi (Sejdi) Bekteshi, Nuradin (Nazif) Hasani, Nexhat (Jahir) Tahiri, Naser (Nezir) Ademi, Nebih (Shaban) Maloku, Nexhmedin (Ramiz) Shabani, Naim (Murat) Bajraktari, Naim (Rizah) Dajaku, Osman (Idriz) Hoti, Osman (Xhemajl) Istrefi, Osman (Azem) Rreci, Qamil (Xhelil) Krasniqi, Raif (Brahim) Qela, Rushit (Shaban) Strana, Ramiz (Adem) Beqiri, Ramadan (Zenel) Kalludra, Ramadan (Bajram) Tahiri, Raif (Feriz) Munishi, Rasim (Daut) Salihu, Rifat (Adem) Hasani, Raif (Faik) Peci, Rexhep (Nebih) Ibrahim, Ramadan (Vesel) Fazliu, Rexhep (Ismet) Barku, Ramadan (Ilaz) Isufi, Rifat (Salih) Hasani, Riad (E) Begu, Rifat (Hetem) Xani, Ramadan (Osman) Vojvoda, Ramadan (Bislim) Musa, Ramiz (Sahit) Dubreva, Rasim (Haradin) Beqiri, Rexhep (Shefqet) Uka, Rrahman (Sherif) Istrefi, Rrahman (Haxhi) Maliqi, Sadri (Dibran) Dibrani, Skender (Arif) Peci, Sami (Bilall) Bilalli, Sadik (Selim) Hasani, Sokol (Osman) Kurteshi, Sabit (Osman) Kurteshi, Sedat (Bedri) Kelmendi, Selim (Gani) Kelmendi, Sami (Emin) Selimi, Salih (Sylë) Babaj, Selim (Bajram) Dragaj, Sami (Mftar) Kerolli, Selman (Ramadan) Qitaku, Salih (Shaban) Azemi, Sahit (Bejtë) Strana, Safet (Mehmet) Ferizi, Sami (Skender) Hasani, Sami (Halim) Rrustemi, Selim (Jashar) Sadiku, Selim (Murat) Voca, Sefer (Milazim) Peci, Sinan (Bahtir) Pllana, Skender (Hamdi) Bajraktari, Sadat

Krimet tjera

Forcat serbe përveç që ekzekutuan, vranë, masakruan, zhdukën, plagosën e burgosën qindra shqiptare; ato dogjën mijëra objekte banimi, dhjetëra objekte shkollore, kulturore e fetare: xhami, biblioteka, ambulanca shëndetësore; trafo të rrymës, kulla të lashta; plaçkitën mbi 250 traktorë, makina transportuese, vetura, autobusë; helmuan 118 puse (bunare), therën 1 381 lopë, 4 582 dele, 281 buallica etj.⁴⁶ Më konkretisht në Mitrovicë janë djegur 7 399 objekte. Në zonat urbane: 3 103 objekte (41, 94)%; në zonat suburbane (periferia): 814 objekte (11%); në zonat rurale (fshatra) 3 482 objekte (47, 06%).⁴⁷

Janë djegur 8 objekte shëndetësore, 5 zyra të vendit (bashkësi lokale); 19 xhami, teqe dhe objekte të tjera fetare; 8 fabrika industriale, 21 fabrika të përpunimit të drurit (pronë private), rreth 1 000 kub dërrasa lëndë druri. Gjithashtu, janë plaçkitur dhe djegur rreth 15 000 automjete: vetura, kamionë, makina shirëse, traktorë, autobusë, motoçikleta etj. Janë vrarë e plaçkitur mbi 20 000 krerë bagëti (lopë, dele, buallica) etj.⁴⁸

(Sejdi) Brahimi, Sabit (Qamil) Haxha, Sabri (Selman) Meha, Sabit (Nuredin) Baliu, Selim (Hasan) Nura, Sabri (Musli) Brahimi, Salih (Muharrem) Veseli, Skender (Sadik) Hajzeri, Salih (Ramadan) Imeri, Sokol (Hashim) Sylja, Sadri (Osman) Sadriu, Sefer (Mehmet) Osmani, Sami (Rrahman) Bala, Sali (Muharrem) Salihu, Smajl (Selim) Sheremeti, Shukri (Ragip) Rama, Sheremet (Izet) Ferizi, Sheremet (Halim) Peci, Shaqir (Sejdi) Ferizi, Sherif (Rifat) Latifi, Shefki (Rifat) Latifi, Shefqet (Rrahim) Berisha, Shaban (Haki) Grepri, Shefqet (Kamer) Haxha, Shefqet (Avdyl) Beqiri, Shkëlzen (Mehdi) Pllana, Shpend (Shaban) Kopriva, Shaqir (Ahmet) Pllana, Sheremet (Behxhet) Beka, Shaban (Hamdi) Berisha, Shefqet (Behxhet) Beka, Shefqet (Ragip) Peci, Shaban (Ramada) Veseli, Shukri (Bejtë) Bahtiri, Shaip (Muharrem) Aliu, Tahir (Avdyl) Beqiri, Tafil (Muharrem) Uka, Ukshin (Bilall) Fetahu, Urhan (Hajriz) Bislimi, Ujup (Fazli) Fazliu, Valdet (Asllan) Morina, Vedat (Enver) Dobreva, Xhafer (Osman) Rama, Xhafer (Shaqir) Sadiku, Xhemshit (Hamit) Ferati, Xhevat (Ahmet) Shala, Xhafer (Bajram) Kadriu, Xhafer (Mehmet) Jashari, Xhafer (Ahmet) Azemi, Xhavit (Musli) Berisha, Xhafer (Ramadan) Shala, Xhafer (Mustafë) Mustafa, Xhafer (Nuredin) Rama, Xhelal Bejtullahu, Xhemail (Jetullah) Aliu, Xhemshit (Adem) Cimili, Zenel (Sinan) Hajrizaj, Zejadin (Isa) Hasani, Zejnullah (Zeqir) Shala, Zejadin (Isa) Hasani, Zenun (Muhamet) Deliu, Zeqir (Jashar) Fejzullahu, Zymer (Mehmet) Osmani, Zeqir (Hysen) Kelmendi, Zejnullah (Aziz) Ibrahim⁴⁵.

⁴⁶ Fazli Hajrizi, *Mitrovica dhe Shala e Bajgorës në fokusin e historisë*, SHB “Libri shkollor”, Prishtinë, 2011, f. 513.

⁴⁷ Jusuf Osmani, *Krimet serbe në Kosovë, 1998-1999*, Prishtinë, 2010, f. 457-550.

⁴⁸ Fazli Hajrizi, *Mitrovica dhe Shala e Bajgorës në fokusin e historisë*, SHB “Libri shkollor”, Prishtinë, 2011, f.513.

Kriminelët e dekoruar

Në fund duhet theksuar se shteti i Serbisë në vend se të kërkonte falje dhe t'i dënonte kriminelët për krimet e kryera në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe Mitrovicën, ai i ka shpërblyer ata me dekorata. I ka shpërblyer me dekorata për krimet që kanë kryer.⁴⁹ Ideatori dhe përgjegjësi kryesor për krimet në Kosovë, presidenti i RFJ-së, Slobodan Millosheviqi, ka dekoruar me *Urdhrin Heroi Kombëtar*, komandantin e Brigadës 125 të motorizuar, kolonel Dragan Zhivanoviq. Dekorata e njëjtë i është dhënë edhe Brigadës 37 të motorizuar, komandant i të cilës ishte koloneli Lubisha Dikoviq, kurse *Urdhri i Flamurit të Luftës* i ishte dhënë edhe Brigadës 211, edhe Brigadës 15 të karrocuar. Të gjitha këto njësi ushtarake kanë vepruar dhe kryer krime edhe në Mitrovicë.⁵⁰

Krimet sigurisht do të ishin shumë më të mëdha po të mos ishte edhe lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila shtrihej edhe në rajonin e Mitrovicës. Zona Operative e Shalës, si njësi e UÇK-së, e cila nga 2 500 ushtarë sa kishte, në mbrojtje të popullatës nga masakrat e tjera të mundshme, në luftë me forcat kriminale serbe, për t'iu kundërvënë atyre forcave, la të vranë 136 ushtarë dhe komandantë, kurse 209 ishin plagosur.⁵¹

⁴⁹ Human Rights Watch, *Nën pushtetin e urdhrave-Krimet e luftës në Kosovë*, New, York, Washington, London, Brussels, 2002, f.102, qasja 2.05.2020.

⁵⁰ Human Rights Watch, *Nën pushtetin e urdhrave-Krimet e luftës në Kosovë*, New, York, Washington, London, Brussels, 2002, f.102, qasja 02.05.2020.

⁵¹ Lista e dëshmorëve dhe të plagosurve të Zonës Operative të Shalës, Arkivi i Zonës IV Mbrojtëse të TMK-së, Sektori ushtarako-Civil, Mitrovicë, 2007.